

**ANJEZA LLUBANI**

**Titulli:** MsC

**Fusha e ekspertizës kërkimore:** Histori Arkitekture dhe Restaurim - Arkitekturë

Profesor Anjeza Llubani ka studjuar për Arkitekturë në Universitetin IUAV – Arkitekturë, Venecia, Itali.

Ajo ka kryer studimet universitare dhe ato post-universitare (Bachelor dhe Master) në Arkitekturë dhe është diplomuar në vitin 2013. Ka një eksperiencë të gjatë profesionale si arkitekthe pranë studios Rizzi PRO.TEC.O në Venecia, kryesisht në adaptimin arkitektonik dhe restaurim (hulumtimi dhe projektimi i qytetit të Cortina's - Itali, draft-propozimi për zhvillimin urban të qytetit të Abruzzo Itali). Në vitin 2011 ka marrë pjesë në Konkursin Evropian të Arkitekturës, me projektimin e qytetit të Dubrovnikut, jashtë mureve të qytetit të vjetër. Ark. Llubani është përfshirë në projekte të ndryshme të pavarura arkitektonike dhe urbanistike. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë si dhe ka prezantuar në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo është e angazhuar si hulumtuese pranë Institutit Adriapol, si dhe është përfshirë në projekte të ndryshme në lidhje me rikualifikimin dhe vlerësimin e planifikimit urban, trashëgimisë dhe projektimit arkitektonik. Ark. Llubani ka gjithashtu një eksperiencë të gjatë akademike si pedagoge e lëndëve Histori Arkitekture nga pre-historia deri në historinë bashkëkohore, Restaurim dhe Metodologji, si dhe lëndën Rikuperimi dhe Vlerësimi i Trashëgimisë Arkitektonike. Ark. Llubani ka qenë disa herë lektore e ftuar në Universitetin Politeknik të Barit, në kuadër të programit Erasmus+ të Komisionit Evropian.